



NJOFTIM SHTYPI

Konsulentët Shqiptarë kanë tashmë organizatën e tyre profesionale - “Albanian Consulting Network (ACN)”

Programi BAS i BERZH në Shqipëri dhe Rrjeti i Konsulentëve Shqiptarë “Albanian Consulting Network” organizuan eventin lançues të organizatës së sapo krijuar të Rrjetit të Konsulentëve Shqiptarë (ACN). Eventi u zhvillua ditën e Enjte në datën **6 Dhjetor 2012, nga ora 16:00 - 19:00 në Tiranë, në Hotel Tirana International, salla Abret.**

Lançimi i ACN kurorzon përpjekjet e një grupi konsulentësh lokalë, të mbështetur nga Programi BAS në Shqipëri në vite, për të rritur ndërgjegjësimin ndërmjet konsulentëve profesionistë për nevojën dhe përfitimet e mundshme nga bashkimi në një organizëm të përbashkët me qëllim forcimin dhe avancimin e profesionit të konsulencës në menaxhim në Shqipëri.

ACN do synojë të rrisë standardet kombëtare të menaxhimit të biznesit dhe praktikat më të mira në tregun e konsulencës lokale, në mënyrë që të plotësojë nevojën në rritje dhe kërkesat e bizneseve që operojnë në Shqipëri.

Me vizionin për t’u bërë institucioni lider i konsulencës profesionale shqiptare, ACN është e gatshme dhe e aftë për të kontribuar drejt adresimit të sfidave në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, si dhe në integrimin e tij në Bashkimin Evropian.

‘Përdorimi i vlerave të shtuara të Konsulencës në Menaxhim është një nga mjetet më efektive në zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në Shqipëri’ shprehu bindjen z. Enno Bozdo, Zv. Ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë.

Z. Fabio Serri, Drejtor i Zyrës së BERZH në Tiranë, solli në vëmendje për auditorin kontributin e rëndësishëm të BAS në Shqipëri, për zhvillimin e konsulencës në biznes si një profesion. Nëpërmjet projekteve dhe trajnimeve të BAS në 6 vitet e fundit, konsulentët shqiptarë kanë zhvilluar aftësitë profesionale. Gjithashtu, BAS Shqipëri ka mbështetur aktivisht nismën për krijimin e ACN.

‘Çdo kompani profesionale konsulente që është e përkushtuar për të ruajtur standardet më të larta profesionale, që pajtohet me kodin tonë të etikës dhe plotëson kërkesat e anëtarësimit, është e mirëpritur të bashkohet me ACN ’ ishte ftesa e qartë e Dr.Arben Memo, Kryetar i Bordit të ACN.

"Për të punuar si konsulentë ju duhet të jeni profesionalisht kompetentë, plot me energji dhe entuziazëm", beson Znj. Monika Farka, anëtare e Bordit të ACN. "Ju gjithmonë duhet të jeni një hap përpara klientit gjë e cila nga konsulenti kërkon jo vetëm një nivel të lartë profesional, por edhe të mësuarin gjatë të gjithë jetës. Në fund të çdo detyre ju duhet të shkoni përtej pritshmërive të klientit pasi për të mbajtur një klient është shumë më e lehtë se sa të përvetësoni një të ri " deklaroi ajo.

"Ambicia e ACN është që të bëhet zëri zyrtar i profesionit të konsulencës në Shqipëri dhe tu sigurojë konsulentëve një platformë për të shprehur opinionet dhe shqetësimet e tyre", përfundoi Dr. Arben Memo.

Të gjithë konsulentët pjesëmarrës morën një paketë aplikimi dhe u ftuan për t’u bërë anëtarë të organizatës ACN.

Për informacione të mëtejshme ju lutem kontaktoni Rrjeti i Konsulentëve Shqiptarë (ACN):

Tel / Fax: (04) 2227674

E-mail: office@albconsulting.org

Web: www.albconsulting.org